

RAPORT PËR MONITORIMIN E RREGULLSHMËRISË SË PROCESIVE GJYQËSORE

1. Hyrje

Komiteti Shqiptar i Helsinkit ka në fokusin e punës së tij edhe respektimin e të drejtave të njeriut në një proces gjyqësor. Për këtë qëllim, organizata ka ndërmarrë disa studime lidhur me të drejtat e të miturve në procesin penal, ofrimin e ndihmës ligjore falas nga shteti dhe nga sektori privat, respektimin e të drejtave të njeriut në një proces gjyqësor, etj.

Bazuar në identifikimin e disa problemeve në veprimtarinë e organeve të drejtësisë në Shqipëri, me të cilat jemi ndeshur në punën tonë të përditshme, ose që janë bërë publike nga aktorë të tjerë, kombëtarë dhe ndërkombëtarë, KShH, gjatë vitit 2011 ka ndërmarrë monitorime sporadike dhe të planifikuara në disa gjykata të vendit, si në Gjykatën e Lartë, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë (dhoma penale), Kavajë, Elbasan, etj.

Qëllimi i vëzhgimeve ishte monitorimi i respektimit të të drejtave të palëve ndërgjyqëse, ose personave të tjerë që përfshihen në gjykim, respektimi i solemnitetit, zbatimi i kodit të etikës, përfundimi i proceseve të gjyqimit brenda një afati të arsyeshëm, respektimi i orarit të seancave gjyqësore, përmirësimi i aksesit të qytetarëve në organet e drejtësisë si dhe efektiviteti i sistemit gjyqësor.

Vëzhguesit tanë e kanë mbështetur punën e tyre mbi një pyetësor të përgatitur nga KShH, i cili i ka ndihmuar ata të identifikojnë më saktë problematikën. Monitorimet janë kryer gjatë periudhës Qershor - Nëntor 2011. Numri i seancave të monitoruara në total është 60, nga të cilat 33 seanca janë monitoruar në Gjykatën e Rrethit Kavajë. Pjesa më e madhe e seancave gjyqësore të monitoruara janë të lidhura me çështje penale dhe një pjesë janë kërkesa penale me objekt ulje denimi, shuarje mase sigurimi, perjashtim gjyqtari, etj.

KShH ka zhvilluar monitorime të tilla edhe më parë dhe vërejtjet dhe sugjerimet e dala prej tyre i janë përcjellë, në kohë, vetë sistemit gjyqësor, si dhe pushteteve të tjera. Duke iu kthyer përsëri monitorimit të seancave gjyqësore, për të verifikuar, pothuaj, të njejtat drejtime pune, kemi patur për qëllim të shohim edhe zhvillimet në këtë drejtim.

Përmirësimi i veprimtarisë së pushtetit gjyqësor është evidentuar në Progres Raportin e Komisionit Europian, si një nga 12 çështjet kyç që vendi ynë duhet të plotësojë me prioritet, në kuadër të integritetit europian, përveç faktit të rëndësishëm se pa një sistem gjyqësor të drejtë e të paanshëm, të drejtat e njeriut dhe demokracia në vendin tonë janë në pikëpyetje të madhe.

2. Gjetjet e monitorimit lidhur me rregullshmërinë e procesit gjyqësor

2.1 Parimi i publicitetit

Parimi i publicitetit të seancës gjyqësore sanksionohet në nenin 42/2 të Kushtetutës, në nenin 6/1 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, si edhe në Kodin e Procedurës Penale, në nenin 339 të tij ku thuhet se: *“Seanca gjyqësore është publike, përndryshe quhet e pavlefshme”*. Me këtë sanksionim të rëndësishëm garantohet se kushdo që ka interes, mund të marrë pjesë për të dëgjuar një seancë gjyqësore, sa kohë që gjykata nuk ka vendosur me vendim të arsyetuar, ta zhvillojë seancën me dyer të mbyllura, për rastet që ligji e lejon një gjë të tillë.

Publiciteti i zhvillimit të një seance gjyqësore fillon me shpalljen publike të orës e datës së zhvillimit të saj, nëpërmjet afishimit në një vend të dukshëm, në ambientet e gjykatës; me thirrjen e seancës në mënyrë publike dhe më tej me zhvillimin e seancës me dyer të hapura. Në pothuajse të gjitha seancat gjyqësore të monitoruara u konstatua se është bërë njoftimi publik.

Në disa nga gjykatat e monitoruara si në Gjykatën e Lartë, Krimeve të Rënda dhe Gjykatën e Rrethit Tiranë u vu re se funksionon faqja e internetit online, nëpërmjet të cilës çdo qytetar mund të ketë akses të plotë në kalendarin e çështjeve që do të gjykohen. Në këto gjykata është lehtësisht i aksesueshëm nga qytetarët edhe këndi i afishimit të listave të gjyqeve. Në Gjykatën e Lartë, thirrja e palëve për të hyrë në sallën e gjykimit bëhej nga sekretaria nëpërmjet aparateve fonike, në respektim të procedurave për njoftimin e palëve.

Përsa i përket Gjykatës së Rrethit të Kavajës, faqja e internetit të saj nuk funksiononte, ndërkohë që u vërejtën dhe probleme me afishimin e listave të seancave gjyqësore, për shkak se ato ishin vendosur në një hapësirë të vogël, listat ishin vendosur mbi njëra tjetrën, duke përfshirë këtu dhe lista të vitit 2010. Mbetet shqetësuese mospërcaktimi në lista të vendit të zhvillimit të procesit gjyqësor, duke krijuar konfuzion.

Një problem tjetër i konstatuar në këtë gjykatë ishte mosthirrja e palëve në mënyrë publike përpara se të fillonte gjykimi.

2.2 Respektimi i solemnitetit të seancave gjyqësore

Nga monitorimi u konstatua se në përgjithësi parimi i solemnitetit të seancave gjyqësore respektohej, duke përfshirë veshjen e gjyqtarëve, prokurorëve, avokatëve, sjelljen e pjesëmarrësve gjatë gjykimit, zhvillimin e seancave në sallë, etj, me përjashtim të disa seancave gjyqësore të zhvilluara në Gjykatën e Lartë, në çështjen e ngritur nga organi i Prokurorisë kundër z.Illir Metës, në të cilën pala mbrojtëse nuk ka respektuar etikën e komunikimit. Gjithashtu, pati dhe raste të prishjes së solemnitetit të gjykimit nga përdorimi i celularëve në seancat gjyqësore, në Gjykatën e Rrethit Kavajë. Më poshtë po ndalemi më gjerë për gjetjet në lidhje me çdo element të solemnitetit të gjykimit.

▪ Ambienti ku zhvillohet gjykimi

Në vendimin nr.238, datë 24.12.2008 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD) është përcaktuar se të gjitha proceset gjyqësore, përsa është e mundur, duhet të zhvillohen në salla gjykimi të përshtatshme për natyrën e çështjes konkrete.

Nga monitorimi i kryer u konstatua se në Gjykatën e Lartë, në atë të Krimeve të Rënda, Gjykatën e Kavajës dhe pjesërisht në Gjykatën e Tiranës, sallat ku zhvillohen proceset gjyqësore penale janë të pajisura me infrastrukturën e nevojshme. Nga 60 seanca gjyqësore të monitoruara, gjashtë prej tyre janë zhvilluar në zyrën e gjyqtarit. Ky fenomen rezulton më së shumti nga mungesa e infrastrukturës por ka patur raste dhe për shkak të mosorganizimit të brendshëm të punës.


▪ **Vonesat ne Fillimin e Seancave**

Në vendimin e KLD Nr.438 datë 24.12.2008 përcaktohet se: *“Proceset gjyqësore duhet të fillojnë në respektim të orarit të gjykimit të komunikuar dhe afishuar në gjykatë, me përjashtim kur ka një arsye të justifikuar. Sekretarja gjyqësore thërret në orar subjektet procedurale për fillimin e gjykimit dhe i orienton për vendin e zhvillimit të tij...”*

Në të gjitha gjykatat e monitoruara janë vënë re vonesa në fillimin e çështjeve gjyqësore. Ajo që është për t'u evidentuar është se në shumicën e rasteve, trupi gjykues nuk relatton shkakun e nisjes së seancës gjyqësore me vonesë.

Nga monitorimi i kryer, ka rezultuar se 27 seanca gjyqësore kanë filluar me vonesë ndërsa 33 seanca kanë filluar në orar. Vetëm në një nga seancat e filluara me vonesë u relatua shkakun e vonesës. Vonesat kanë variuar nga 5 minuta deri 45 minuta.

Shih tabelën e mëposhtme lidhur me zhvillimin e seancave gjyqësore



▪ **Veshja e posaçme në gjykim**

Nga monitorimi ka rezultuar fakti pozitiv se në asnjë nga rastet nuk është konstatuar mospërdorimi i veshjes së posaçme nga gjyqtari. Mbajtja e veshjes së posaçme është respektuar në të gjitha proceset e zhvilluara në Gjykatën e Shkallës së parë të Krimeve të Rënda, në Gjykatën e Kavajës, në Gjykatën e Lartë. Rastet e konstatuara të mospërdorimit të

veshjes së posaçme janë evidentuar në Gjykatën e rrethit Tiranë dhe sidomos në rastet kur gjykimet janë bërë në zyrën e gjyqtarit.

- **Etika dhe sjellja gjatë gjyimit**

Vendimi nr.438 datë 24.12.2008 i KLD-së përcakton qartë rregulltat dhe etika që duhet të ndiqet gjatë një procesi gjyqësor¹.

Nga monitorimi i kryer ka rezultuar se në përgjithësi etika e komunikimit në përgjithësi është respektuar nga palët dhe nga organet gjyqësore si trupi gjykues, prokurori dhe avokatët. Përrjashtim përbëjnë disa seanca gjyqësore në të cilën etika e komunikimit nga pala mbrojtëse nuk është respektuar në Gjykatën e Lartë në çështjen me të akuzuar z. Ilir Meta.

Zhvillimi i gjyimit në zyrën e gjyqtarit bën që etika e komunikimit të shkelet herë pas here. Janë vërejtur raste të tilla, kryesisht në Gjykatën e Rrethit Kavajë që seanca gjyqësore ndërpritej për shkak të zileve të celularëve të gjyqtarëve, avokatëve ose prokurorëve, por dhe për shkak të hyrjes së personave të ndryshëm në zyrën e gjyqtarit. Pjesë e solemnitetit është dhe mënyra e shpalljes së vendimit përfundimtar të gjyimit të një çështjeje. Shpallja e vendimeve është bërë publikisht, por u paarsyetuar duke u shpallur vetëm dispozitivi. Përrjashtim bën Gjykata e Lartë, trupat gjykues të të cilës vendimet e ndërmjetme i shpallnin të arsyetuara shkurtimisht. Nga vëzhgimi i kryer rezulton se disa vendimeve janë shpallur në zyrën e gjyqtarit dhe jo në sallë, siç e kërkon ligji.

Pothuajse në të gjitha rastet, trupi gjykues ka respektuar mënyrën e marrjes së vendimeve të ndërmjetme dhe ato përfundimtare duke u tërhequr për vendim dhe duke u rikthyer para publikut për shpalljen e tij më pas.

2.3 Zvarritja e proceseve gjyqësore

Përrfundimi i gjyimit brenda një afati të arsyeshëm dhe pa shkëputje është në shumë raste “thembra e Akilit”, për një sistem drejtësie të efektshëm. Pothuajse në të gjitha monitorimet e kryera nga KShH gjatë këtyre viteve, është evidentuar zvarritja e proceseve gjyqësore, të cilat në të shumtën e rasteve janë bërë nëpërmjet hapësirave ligjore të gjetura nga palët.

Në nenin 42/2 të Kushtetutës është përcaktuar se ...*Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe të interesave të tij kushtetuese dhe ligjore, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik **brenda një afati të arsyeshëm** nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj...*

¹ 1) Gjatë gjyimit, palët pjesëmarrëse duhet të mbajnë qëndrim korrekt dhe sjellje që shpreh respekt për trupin gjykues duke shmangur çdo lloj veprimi të papërshtatshëm në sjellje dhe në të shprehurit e tyre, si në komunikimin me trupin gjykues, me subjektet e tjera apo të pranishmit në sallë;

2) Komunikimi ndaj trupit gjykues nga palët dhe të pranishmit e tjerë në proces, duhet të bëhet me ton të përshtatshëm duke iu drejtuar me formën e mirësjelljes “Ju” ose me shprehjen “I nderuar”;

3) Palët pjesëmarrëse në proces duhet të flasin në këmbë përpara trupit gjykues apo gjyqtarit/gjyqtares, po kështu edhe ekspertët apo dëshmitarët e thirrur gjatë procedurës së betimit, me përrjashtim të rasteve kur gjendja shëndetësore nuk ua lejon një gjë të tillë.

Në nenin 6/1 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut parashikohet se “...Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe **brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t’i ndalohej shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë...**”

Kështu në çështjen “**Gjonboçari kundër Shqipërisë**”², Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), ka konstatuar shkelje të nenit 6/1 të konventës për sa i përket tejzgjatjes së procesit duke përcaktuar edhe detyra apo udhëzime për shtetin shqiptar me qëllim shmangien e tyre në të ardhmen. Bazuar në këtë fakt, GJEDNJ rikujton sipas nenit 6 të Konventës se “...çdo njeri ka të drejtën e një vendimi gjyqësor përfundimtar, brenda një kohë të arsyeshme, për gjykimin e çështjeve mbi të drejtat dhe detyrimet civile. **Shtetet palë janë të detyruara të modifikojnë sistemet e tyre ligjore në menyrë që të lejojnë gjykatat të pershtasin praktikën e tyre sipas kësaj kërkesë të Konventës...**”

Gjykata e Strasburgut ka theksuar së fundmi se, **atje ku sistemi gjyqësor ka mangësi në lidhje me kërkesën mbi kohëzgjatjen e procedurave sipas nenit 6/1 të Konventës, krijimi i një mjeti ankimi për të përshpejtuar procedurat me qëllim parandalimin e tejzgjatjes së tyre është zgjidhja më e mirë.** Disa shtete e kanë kuptuar situatën në mënyre perfekte duke zgjedhur kombinimin e dy tipareve të mjeteve të ankimit, njëra e krijuar për përshpejtimin e procedurave dhe tjetra për të rregulluar kompensimin (*shih Scordino kundër Italisë nr. GC 36813/97/183, 186 ECHR 2006*).

Duke iu kthyer rastit konkret, GJEDNJ vëren ashtu siç edhe pala shqiptare ka pranuar, se sistemi ligjor shqiptar, përveç ankesave lidhur me të drejtat kushtetuese, nuk parashikon një mjet ankimi të veçantë, të cilin ankuesit mund ta kishin përdorur me qëllim adresimin e pretendimeve të tyre për tejzgjatjen e procedurave³. Duke vlerësuar se, “*Pohimi i tyre se tejzgjatja e procedurave nuk përbën problem në sistemin vendas është i pabazuar dhe për çdo rast, nuk është përgjigje e ankesës së ankuesve mbi tejzgjatjen e procedurave, të cilën gjykata e gjen si të paarsyeshme*”, GJEDNJ vendosi **se ka pasur shkelje të nenit 13 të lidhje me nenin 6/1 të Konventës, për sa i përket tejzgjatjes së procedurave.**

Në çështjen “Gjyli kundër Shqipërisë” dhe çështjen “Nuri kundër Shqipërisë”⁴, GJEDNJ ka arritur në të njëjtin konkluzion në lidhje me afatin e arsyeshëm që parashikon neni 6/1 i Konventës.

Shumë raste të shkeljes së nenit 42/2 të Kushtetutës dhe të nenit 6/1 të KEDNJ janë

² Shih vendimin e datës 31 mars 2005 dhe 31.3.2008

³ *Inter Alias*, shih çështjen “Kudla kundër Polonisë”

⁴ Shih respektivisht vendimin e datës 29 shtator 2009 dhe vendimin e datës 03.02.2009

konstatuar nga Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë. Në vendimet e GJEDNJ-së, shtetit Shqiptar i është sugjeruar edhe gjetja e procedurave efikase për të shmangur një gjykim të tejzgjatur. Mosgjetja e mjeteve efikase për “afatin e arsyeshem” dhe manifestimi në mënyrë të ekzagjeruar i këtyre praktikave zvarritëse, sidomos për proceset më sensitive që kanë tërhequr vëmendjen e publikut, ngarkon me përgjegjësi Ministrinë e Drejtësisë, Këshillin e Lartë të Drejtësisë dhe të gjitha institucionet e tjera përgjegjëse.


Nga vëzhgimi i seancave gjyqësore, ku bazohet ky raport, ka rezultuar se mungesa e avokatit ose të pandehurit ka çuar në shtyrje të shumta të seancave gjyqësore. Kjo mangësi u vu re pothuajse në të gjitha gjykatat e monitoruara.

Vlen të përmendet një rast tepër i veçantë që konsiderohet si zvarritje e procesit, apo shtyrje e pajustificuar e tij, por me karakter te dyfishtë. Në një seance në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë me objekt “Kundërshtimin e Vendimit të Prokurorisë”, avokati kishte kërkuar përjashtimin e gjyqtarit. Sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale, gjykata kishte ndërprerë gjykimin për t’u shprehur një tjetër trup gjykues në lidhje me kërkesën. Trupi tjetër gjykues kishte caktuar dy seanca, por avokati i palës kerkuese nuk paraqitej duke çuar kështu në shtyrjen e dy gjykimeve. E përmendëm këtë rast, si një nga rastet me flagrante të cilat shtyjnë për një kohë të gjatë gjykimin e çështjes edhe kur ajo është e thjeshtë, duke rritur njëkohësisht, në mënyrë artificiale, kohën e gjyimit të çdo çështje, por edhe numrin e çështjeve në gjykim për çdo gjyqtar.

- **Mungesa e palëve**

Lidhur me prezencën e palëve në seancat gjyqësore të monitoruara, ka rezultuar se nga 60 seancat e monitoruara, 15 janë seancat në të cilat ka patur mungesa të palëve. Nga këto, 4 ka qënë numri i seancave ku kanë munguar të dyja palët, në 7 seanca ka munguar avokati ose i pandehuri dhe në 6 të tjera ka munguar prokurori.

Më poshtë jepet një shpërndarje grafike e seancave sipas palëve që kanë munguar



Kësaj çështje në monitorim i është kushtuar një vëmendje e veçantë për shkak se nga

praktika vërehet se shtyrja e seancave gjyqësore për shkak të mungesës së palëve është bërë shumë problematike dhe ka marrë përmasa të medha. Kjo për shkak, se prania e subjekteve procedurale në seancën gjyqësore është e domosdoshme, përndryshe mungesa e prokurorit, avokatit ose të pandehurit bën që seanca të shtyhet.


Nga vëzhgimi i seancave gjyqësore në gjykatat e monitoruara, ka rezultuar se shkaqet kryesore të shtyrjes së seancave gjyqësore kanë qenë të ndryshme, si:

- **Mungesa e prokurorit në seancë gjyqësore**, ku në disa raste nuk është dhënë as arsyeja e mungesës së tij, e cila çon në shtyrjen e procesit gjyqësor për një datë tjetër.
- **Mungesa e avokatit/pandehurit, e cila** është evidentuar në të shumtën e rasteve nga monitorimi. Nga 60 rastet e monitoruara ka rezultuar se avokati/pandehuri ka munguar gjithsej në 23 raste, nga të cilat në 17 prej tyre pa dhënë asnjë shkak. *(shih tabelën e mëposhtme).*

Arsyet e mospjesëmarrjes së të pandehurve në gjykim kanë qenë nga më të ndryshmet, si psh: mosmarrja njoftim për zhvillimin e gjykimit, mosparaqitja pa dhënë asnjë shkak; mosshoqërimi nga ambientet e paraburgimit apo nga spitali psikiatrik i të pandehurit që kërkon të marrë pjesë në gjykim; mosgjatja e adresave të sakta për të njoftuar të pandehurit në gjendje të lirë. Në disa raste rezulton se organi i akuzës, kur e dërgon dosjen në gjykatë, nuk ka pasqyruar në të adresë të saktë të të pandehurit, duke bërë që të shtyhen disa seanca vetëm për njoftimin e tyre dhe të vihen në lëvizje institucione të tjera.

- **Mosformimi i trupit gjykues**, ka rezultuar në disa seanca gjyqësore, ku gjyqtarët kanë munguar në gjykim për shkaqe familjare apo edhe shkaqe të mbivendosjes në kohë të proceceve gjyqësore, kryesisht ato me trup gjykues tresh. Kjo e fundit nxjerr në pah mungesën e organizimit të punës në gjykata.

Në tabelën e mëposhtme jepet grafiku i mungesave që kanë shkaktuar shtyrjen e seancave gjyqësore, duke i ndarë ato në shtyrje të justifikuara dhe në shtyrje prej mungesave pa asnjë shkak.




b) Afati i shtyrjes së seancës gjyqësore

Në nenin 342 të Kodit të Procedurës Penale përcaktohet se: *“Kur shqyrtimi gjyqësor nuk mund të përfundohet në një seancë të vetme, gjykata vendos që ta vazhdojë në ditën e mëpasme të punës. Më tej, gjykata mund të ndërpresë shqyrtimin gjyqësor, vetëm për arsye të veçanta, deri në 15 ditë”*.

Nga monitorimet e mëparshme të kryera nga KShH, ashtu si dhe nga monitorimi i fundit, ka rezultuar se kjo dispozitë nuk gjen zbatim. Kryesisht kjo vjen për shkak të ngarkesës që kanë gjyqtarët sidomos në Gjykatën e Rrethit Tiranë por edhe në Gjykatat e tjera dhe nga organizimi jo i mirë i punës. Gjykatat në shumicën e rasteve kanë zbatuar afatin ligjor për shtyrjen e seancës për një afat brenda 15 ditësh, por pa përmëndur arsyet e veçanta që kërkon neni i sipërcituar.

Në tabelën e mëposhtme paraqitet grafiku lidhur me shtyrjet e seancave gjyqësore




c) Disa nga gjetjet për monitorimin e disa çështjeve gjyqësore sensitive

Gjatë vitit 2011, KShH ka monitoruar në mënyrë të vazhdueshme disa çështje sensitive si çështjen penale nr. 3, rregjistruar në datën 18.04.2008, lidhur me zhdukjen e biznesmenit Remzi Hoxha, e cila po zhvillohet në Gjykatën e Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda. Kjo është një çështje problematike, pasi ka mbi tre vjet e gjysëm që shqyrtohet në gjykatë. Deri në momentin e monitorimit janë zhvilluar rreth 100 seanca gjyqësore dhe çështja vazhdon. Arsyet e tejkëqitjes të kësaj çështje janë në të shumtën e rasteve mungesa e dëshmitarëve, vonesat e letërporosive, mungesa e avokatit, mosformimi i trupit gjykues, etj. Çështja është sensitive sepse janë të akuzuar për vrasje persona që kanë punuar në shërbimet sekrete të shtetit dhe vëmendja e publikut është teper e madhe për të.

Në këtë çështje, rezulton të ketë një numër të lartë seancash të shtyra nga avokati, me apo pa shkak. Në këtë drejtim evidentohet fakti se për seancat ku avokati ka kërkuar shtyrjen, shpeshherë, trupi gjykues pranon kërkesën dhe shtyn seancën. Duke qënë se kemi të bëjmë me çështje të tejkëqitura, do të ishte e domosdoshme që në këto raste të bëhet një verifikim më i hollësishem nga gjykata në lidhje me shkakun që paraqitet për shtyrjen e seancës. Çdo

kërkesë nga avokati, që ka për objekt shtyrjen e seancës gjyqësore duhet patjetër të ketë një justifikim të provuar në lidhje me shkakun e shtyrjes (*Për shembull në rastin e kërkesës për shtyrje kur avokati ka një “përplasje” gjyqesh, kërkesa duhet të shoqërohet me listën e gjyqeve si dhe kopje të prokurës për çështjen ku do të paraqitet avokati*).

Më poshtë gjeni një paraqitje grafike të seancave gjyqësore tek çështja përkatëse:




Një problem tjetër që vihet re sidomos në çështjet në Gjykatën e Krimeve të Rënda, është ekzekutimi i letërporosive, të cilat kanë bërë që të shtyhen rreth 26 seanca gjyqësore në pritje të tyre. Për përmirësimin e situatës, Ministria e Drejtësisë si institucion përgjegjës duhet të marrë masa, për shmangien e “burokracive” të pajustificuara. Shteti shqiptar duhet të përdorë më mirë rrugët diplomatike, duke ushtruar ndikimin e vet për një zgjidhje të shpejtë të problemit, por edhe rrugët ligjore të përcaktuara në Konventat ndërkombëtare të ratifikuara si dhe në marrëveshjet e ndërsjellta. Koncretisht në **Ligjin nr. 8498, date 10.6.1999** “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës “Për ndihmën e ndërsjellë juridike në fushën penale” dhe protokollin e saj shtesë (Ndryshuar me ligjin nr. 9539, date 22.5.2006), në nenin 4 përcaktohet se “*Në qoftëse pala kërkuese e kërkon shprehimisht, pala, së cilës i drejtohet kërkesa, duhet të njoftojë për datën dhe vendin e ekzekutimit të letërporosisë. Autoritetet dhe personat në çështje mund të ndihmojnë gjatë këtij ekzekutimi në qoftë se pala, së cilës i drejtohet kërkesa, do t’ua lejojë*”. Gjithashtu neni 15 i këtij ligji parashikon se “...në rast urgjence, këto letërporosi mund të dërgohen edhe drejtpërsëdrejti nga autoritetet gjyqësore të palës kërkuese, autoriteteve gjyqësore të palës së ciles i drejtohet kërkesa. Kërkesat për ndihmë juridike, të ndryshme nga ato të parashikuara nga paragrafi i parë dhe i tretë i këtij neni, ose në veçanti kërkesat për hetimet paraprake për një proces penal, mund të jenë objekt komunikimi të drejtpërdrejtë nga autoritet gjyqësore... ”.

Në ligjin nr. 8883, datë 18.4.2002 “Për ratifikimin e Protokollit të dytë shtesë të “Konventës së Këshillit të Europës për ndihmën e ndërsjellë juridike në fushën penale” janë përcaktuar edhe “afate kohore” në lidhje me ndihmën e ndërsjellë që shtetet i japin njëri-tjetrit.

Një çështje tjetër e rëndësishme është çështja gjyqësore Nr. 35 datë 11.06.2009 e regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e njohur si çështja “Gërdeci”, e cila ka rreth tre vjet që vazhdon të gjykohet dhe ende nuk ka një vendim të formës së prerë. Edhe kjo çështje është tepër sensitive, jo vetëm për dëmet e mëdha në jetë njerëzish dhe në pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme që ka shkaktuar, por edhe sepse të pandehurit janë funksionarë të lartë të shtetit dhe publiku dëshiron të shikojë sesi evidentohet përgjegjësia penale ndaj tyre, se si zbatohet e drejta kushtetuese për të qënë i barabartë përpara ligjit. Justifikimin vonesat në këtë çështje, gjyqtarët i lidhin me numrin e madh të të pandehurve (rreth 28 te pandehur), me numrin e madh të mbrojtësve ligjore (rreth 30 avokatë) si dhe me numrin e madh të dëshmitarëve dhe provave të depozituara pranë gjykatës.

KShH ka monitoruar dhjetëra seanca gjyqësore të kësaj çështje dhe pavarësisht problematikës së saj, arrin në konkluzionin se ka zvarritje të pajustificuara të seancave gjyqësore. Në këtë konkluzion arrijmë dhe nëpërmjet analizës së treguesve të kësaj çështje të publikuara në faqen e internetit të gjykatës ku shqyrtohet çështja. Deri ne momentin e publikimit të këtij raporti janë zhvilluar rreth 197 seanca gjyqësore, ku në rreth 70 seanca gjyqësore kanë munguar përfaqësuesit ligjor të të pandehurve ose vetë të pandehurit, gjë që ka çuar në shtyrjen e seancës gjyqësore dhe rreth 36 seanca gjyqësore janë shtyrë për shkak të mungesës së dëshmitarëve. Pjesa tjetër e seancave gjyqësore janë shtyrë për të nesërmen për shkak të mbarimit të orarit zyrtar, sidomos kjo vihet re në ato seanca gjyqësore ku organi i prokurorisë ka dhënë konkluzionet e tij përfundimtare të cilat arrijnë disa qindra faqe. Shkaqe të tjera, më të pakta në numër, që kanë ndikuar në shtyrjen e seancave gjyqësore janë mosformimi i trupit gjykues ose kur është kërkuar nga organi i akuzës.

Më poshtë gjeni një paraqitje grafike të seancave gjyqësore tek çështja përkatëse:



3. Rekomandime për përmirësimin e situatës

- KShH sugjeron që të mundësohet sa më parë dhënia e informacionit elektronik lidhur me adresat e personave që do të thirren në gjykim, në një kohë kur ka filluar nga funksioni adresari elektronik për shtetas dhe subjekte, me qëllim shmangien e zvarritjeve të gjykimeve

- Sugjerojmë që Ministria e Drejtësisë të bashkëpunojë me anë të një marrëveshje me Drejtorinë e Postave, me qëllim me njoftimin e personave që duhet të paraqiten në gjykim, duke përfshirë në marrëveshje veprimet që parashikon ligji procedural për vlefshmërinë e njoftimit.
- KShH sugjeron marrjen e masave për një organizim më të mirë të punës së gjykatave, me qëllim njoftimin e palëve në rast të vonesave, pasqyrimin e arsyeve të vonesës ose shtyrjes, shfrytëzimin më të mirë të sallave gjyqësore, duke bërë një grafik të seancave gjyqësore, publikimin më mirë të kalendarit të çështjeve gjyqësore; etj.
- KShH sugjeron që Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe Ministria e Drejtësisë të kryejnë inspektime lidhur me respektimin e kodit të etikës, solemnitetit, parimin e publicitetit, shpalljen e arsytuar të vendimeve gjyqësore në një afat të shpejtë, pa u bërë pengesë për palët që duan ta apelojnë atë, krijimin e aksesit për qytetarët në sistemin gjyqësor, etj.
- Sugjerojmë një koordinim më të mirë të punës të Gjykatave me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, lidhur me paraqitjen e të pandehurve në seancat gjyqësore dhe shmangien e vonesave të tyre.
- Kryetarët e Gjykatave, në rastet e mungesave pa arsye në seancat gjyqësore të prokurorëve dhe avokatëve, duhet të marrin masa për të sinjalizuar menjëherë, respektivisht drejtuesin e Prokurorisë ose Dhomën Kombëtare të Avokatisë.
- KShH sugjeron që Gjykata e Kavajës të marrë masa për afishimin më mirë të listave të seancave gjyqësore, me qëllim përmirësimin e aksesit të qytetarëve në gjykim, si dhe rregullimin e faqes së tyre të internetit.
- Sugjerojmë që KLD të orientojë gjyqtarët që në rastin e çështjeve komplekse, sidomos ato me shumë të pandehur, avokatë, dëshmitarë, ekspertë, etj, të marrin masa efektive për eliminimin e zvarritjeve dhe të shtyrjeve artificiale të seancave gjyqësore, duke mos pranuar kërkesa të pajustificuara për shtyrje. Të nxirret përgjegjësia e profesionistëve që marrin pjesë në gjykim, në rastet kur provohet se përdorin shtyrjen e gjykimit për favor të palës që përfaqësojnë.